



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 162/8 Prot.

Tiranë, më 28 . 08 . 2023

V E N D I M

Nr. 174 , Datë 28 . 08 . 2023

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O N :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 3 e këtij neni, si dhe nenit 33 e 33/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit administrativ, për të shqyrtuar ankesën nr. 171 Regj., datë 09.11.2022, paraqitur nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në emër të shtetasit M. Sh³, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar⁴”, nga ana e Bashkisë Kamëz dhe e Kompanisë “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k.

Bazuar në nenin 33/10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 66, datë 27.04.2023, me anë të të cilit ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetasit M. Sh dhe të gjithë kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz”.

¹ “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

² Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

³ Referuar dakordësisë së ankuesit, sipas formularit të ankesës.

⁴ Referuar Librezës për “Përfituesit e Statusit të të Verbërit”, me nr. 00837, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, me vlefshmëri për periudhën nga data 09.03.2018 deri më datë 09.03.2023.

Në pikën 3, të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur: *“Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie”.*

Në nenin 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 *“Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.*

Për sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 162/6 prot., datë 26.07.2023, Komisioneri i është drejtuar sërish Bashkisë Kamëz, duke i sjellë në vëmendje, se brenda dhjetë ditëve nga marrja dijani e kësaj shkrese, ka detyrimin të zbatojë Vendimin nr. 66, datë 27.04.2023, të KMD-së, si dhe i ka kërkuar të informojë KMD, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.

Komisionerit nuk i është dërguar asnjë përgjigje shkresore lidhur me masat që Bashkia Kamëz duhet të ndërmerre për zbatimin e vendimit të mësipërm të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32/1, shkronja “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/a dhe 14, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Subjekti Bashkia Kamëz, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Gjoha të ekzekutohet dhe të derdhet në Buxhetin e Shtetit jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit, me kërkesë të Komisionerit.

3. Paga e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit nr. 66, datë 27.04.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA